



Procesverbal i Takimit të 11-të të Grupit të aktorëve
për
Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

22 Tetor, 2015
Restorant “Vasili”, Goricë
Republika e Shqipërisë



Pjesëmarrësit në takim:

Struktura e pjesëmarrësve në takimin e 11-të të Grupit të Aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” ka përfshirë 37 pjesëmarrës, antarë të emëruar dhe të rinj të mundshëm për Rajonin e Prespës. Takimi u organizua dhe u facilitua nga Stafi i Njësise së menaxhimit të Projektit me asistencën e Presidentes dhe Zëvendës- Presidentit të grupit të palëve të interesuara për rajonin ndërkufitar “Prespa”.

Lista e plote e pjesëmarrësve dhe detaje për kontaktet e tyre mund të gjenden në:

ANNEX 1: Lista e pjesëmarrësve të takimit të 11-të të grupit të aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” 22.10.2015

ANNEX 2: PPP_Prespa arritjet dhe rezultatet Qershor-Tetor 2015

ANNEX 3: PPP_SWG_GIZ_LEIWW_Mbledhja e grupit të aktorëve Prespa

ANNEX 4: Prezi_Zhvillimi i Integruar Ekonomik në rajonin ndërkufitar “Prespa”

Programi i takimit:

Takimit i 11-të i Grupit të aktorëve Për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

09:30 – 10:00 **Mbërritja e pjesëmarrësve dhe takimi i mirëseardhjes**

10:00 – 10:10 **Fjalimi i mirëseardhjes**

- Z. Edmond Temelko, Kryetar i Bashkisë Pustec
- Znj. Irena Dzimrevska, Shefe Operacionale SWG
- Znj. Viola Bogdani, Presidente e Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa”
- Z. Naume Tashovski, Zëvendës President i Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa”
- Z. Olsi Duma, Parku Kombëtar “Prespa”

10:10 – 10:15 **Prezantimi i programit**

Z. Damjan Surlevski, Menaxher Rajonal për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

10:15 – 10:35 **Arritjet e përgjithshme të zbatimit të ABDA në Rajonin Ndërkufitar “Prespa” (periudha Qershor- Tetor 2015)**

Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

10:35 – 11:00 **Prezantimi i faqes zyrtare të internetit për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”**

Z. Damjan Surlevski, Menaxher Rajonal për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

11:00 – 11:20 **Pushim kafe**

11:20 – 11:40 **Diskutim rreth Protokollit Operacional dhe Rregullat e procedurës për**



grupin e aktorëve “Prespa”

Z. Damjan Surlevski, Menaxher Rajonal për Rajonin Ndërkufitar
“Prespa”

Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për Rajonin Ndërkufitar
“Prespa”

11:40 – 12:00 **Aktivitetet e ardhshme në lidhje me zbatimin e ABDA në Rajonin Ndërkufitar "Prespa"**. Diskutim për mbështetjen në vazhdimësi të programit “Njerëzit për Njerëzit” në rajonin "Prespa"

Z. Damjan Surlevski, Menaxher Rajonal për Rajonin Ndërkufitar
“Prespa”

Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për Rajonin Ndërkufitar
“Prespa”

12:00 – 12:30 **Diskutim rreth projekt propozimeve për Zhvillimin e Integruar Ekonomik**. Vendosija e partneriteteve në vazhdimësi rreth thirrjeve për aplikime në rajonin ndërkufitar “Prespa”

Z. Damjan Surlevski, Menaxher Rajonal për Rajonin Ndërkufitar
“Prespa”

12:30 – 12:45 **Konkluzionet dhe aktivitetet e ardhshme**

12:45 – 13:45 **Dreka**

13:45 – 16:30 **Zhvillimi rural nëpërmjet ujit dhe menaxhimi i pyjeve në Evropën Juglindore**

- Identifikimi dhe vlerësimin i prioriteteve për 4 rajonet pilote ndërkufitare, të cilat mund të përfshihen në strategjinë e projektit;
 - Vlerësimi, verifikimi dhe prioritizimi i fizibilitetit të masave për menaxhimin burimor të integruar të pyjeve dhe ujit;
 - Vlerësimi, verifikimi dhe prioritizimi i fizibilitetit të masave për gjenerimin e të ardhurave nga ana e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore në rajonet pilote, me një fokus aktivitetet ekonomike të grave në kuadrin e të paktën një prej masave.
 - Përcaktimi bazë dhe vlerat e synuara për masat e identifikuar, si dhe burimet përkatëse të verifikimit;
 - Identifikimi i nevojave dhe strategjive për zhvillimin e kapaciteteve në rajonet pilote ndërkufitare;
- Sesioni do moderohet nga ekspertë të GIZ

16:30 – 16:45 **Konkluzionet dhe aktivitetet e ardhshme**

16:45 – 17:30 **Vizitë ne terren në Parkun Kombëtar të Prespës (fakultative)**

Procesverbal i takimit

Takimi u hap me fjalën e mirëseardhjes nga Menaxheri Rajonal për rajonin ndërkufitar "Prespa" Z. Damjan Surlevski, i cili falenderoi pjesëmarrësit për prezencën dhe uroi një bashkëpunim të frutshëm me të gjithë aktorët.



Në emër të Bashkisë pritëse të këtij takimi, Bashkisë Pustec, përshëndeti zoti Z. Edmond Temelko. Ai shprehu kënaqësinë për përfshirjen në aktivitetet të tilla të rëndësishme për rajonin dhe njëkohësisht mbështetjen maksimale institucionale të Bashkisë Pustec.

Më pas Znj. Viola Bogdani, Presidente e Grupit të Aktorëve për Rajonin "Prespa" dhe Z.Naume Tashovski, Zëvendës President i Grupit të Aktorëve për Rajonin "Prespa" përshëndetën të gjithë pjesëmarrësit duke theksuar rëndësinë e konsolidimit të grupit të qëndrueshëm të aktorëve të palëve të interesuara "Prespa" dhe vazhdimin e bashkëpunimit me të gjithë grupin a aktorëve në kuadër të programit ABDA.

Në vazhdim në emër të Parkut Kombëtar "Prespa", Z.Olsi Duma, përshëndeti pjesëmarrësit dhe shprehu besimin e tij për vlerën dhe rëndësinë e programit në zhvillimin rural në rajonin ndërkufitar "Prespa".

Më pas, Z.Damjan Surlevski prezantoi ne detaje programin e takimit duke u ndalur në cdo sesion të programit dhe ceshtjeve për tu trajtuar.

Sesioni 1

Arritjet e përgjithshme të zbatimit të ABDA në Rajonin Ndërkufitar "Prespa" (Periudha qershor-tetor 2015)

Seanca filloi me prezantimin e Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për rajonin ndërkufitar "Prespa", e cila pasi falenderoi grupin për pjesëmarrjen, pasqyroi aktivitetet e kryera dhe arritjet e përgjithshme të zbatimit ABDA për periudhën Qershor 2015 - Tetor 2015.

Në vazhdim, pjesëmarrësit u informuan rreth lehtësimit të procesit të zhvillimit ekonomik të zonave rurale ndërkufitare, zbatimin e masave në rritjen e kapaciteteve për përgatitjen e projekteve përkatëse me cilësinë e duhur, organizimin e takimeve me donatorët që operojnë në rajonin ndërkufitar "Prespa" si edhe mbështetjen për konsulencën e grupit të palëve të interesuara për përgatitjen e projekt propozimeve, thirrjeve të ndryshme dhe organizmin e aktiviteteve Njerëzit për Njerëzit.

Gjithashtu prezantimi u fokusua në ecurinë dhe detajet e veprimeve të ndërmarra, arritjeve të përgjithshme, rëndësinë e tyre për rajonin, përfshirjen e grupit të aktorëve si dhe mundësitë financiare dhe mbështetjen për aktivitetet dhe bashkëpunimin në të ardhmen.

Sesioni 2

Prezantimi i faqes zyrtare të internetit për rajonin ndërkufitar "Prespa"

Gjatë këtij sesioni Z. Damjan Surlevski, Menaxher Rajonal për rajonin ndërkufitar "Prespa" prezantoi punën e bërë për realizimin e faqes së internetit. Ai shpjegoi në detaje të gjitha rubrikat e faqes, duke paraqitur informacionin e pasqyruar, si edhe



mundësinë për pasurimin më tej me informacione shtesë. Z. Damjan Surlevski theksoi rëndësinë e faqes së internetit në prezantimin dhe promovimin e gjërë të rajonit. Ai kërkoi gjithashtu bashkëpunimin e antarëve të grupit të palëve të interesit për të pasuruar këtë faqe me më shumë të dhëna dhe informacione mbi aktivitetet dhe ngjarjet në rajon.

Gjatë kësaj seance pjesëmarrësit diskutuan dhe propozuan se link-u i faqes zyrtare të internet për rajonin Prespa të mund të promovohet në faqet zyrtare që disponojnë aktorët e palëve të interesuara si edhe anasjelltas, faqet e tyre të internetit të promovohen në faqen e internetit Prespa. Kjo do të rrisë jo vetëm aksesin në faqen e internetit Prespa, por gjithashtu do të ndihmojë grupin e palëve të interesuara në konsolidimin dhe angazhimin e vazhdueshëm në organizimin dhe promovimin e aktiviteteve të ardhshme. Gjithashtu në vazhdim të diskutimeve u sugjerua krijimi i hartës elektronike të rajonit për promovimin e rajonit të Prespës dhe atraksioneve të saj.

Përveç kësaj, në lidhje me promovimin e aktiviteteve në rajon, u sugjerua që dokumente të tjera relevante që lidhen me rajonin e Prespës të zhvilluara në nivel lokal dhe kombëtar të pasqyrohen edhe në faqen zyrtare të internetit.

Në fund të diskutimit gjithashtu u propozua për të krijuar një faqe në rrjetin social Facebook, e cila do të administrohet nga njësia e menaxhimit të projektit të Prespës dhe grupi i palëve të interesuara. Kjo do të ndihmojë edhe më shumë në rritjen e vizibilitetit të grupit të aktorëve dhe promovimin e punës së tyre në rajon.

Sesioni 3

Diskutim rreth Protokollit Operacional dhe Rregullat e procedurës për grupin e aktorëve “Prespa”

Gjatë këtij sesioni Z. Damjan Surlevski u kërkoi të pranishmëve një shqyrtim më të hollësishëm të Protokollit Operacional dhe rregullave të procedurës të Palëve të Interesuara me komente dhe sugjerimet konkrete. Kështu, duke parë rëndësinë e këtij dokumenti aktorët propozuar që të vendoset më shumë kohë në dispozicion për ta shqyrtuar dokumentin më në detaje. Në vazhdim, u ra dakord që dokumenti të dërgohet sërish me e-mail grupit të palëve të interesuara për shqyrtim.

Sugjerimet do të dërgohen me e-mail deri në datën 16 nëntor 2015 dhe Protokollit Operacional për grupin e aktorëve “Prespa” dhe Rregullorja e punës do të diskutohet për miratim në mbledhjen e ardhshme.



Sesioni 4

Aktivitetet e ardhshme në lidhje me zbatimin e ABDA në Rajonin Ndërkufitar "Prespa"- Diskutim në vazhdimin e mbështetjes së aktiviteteve "Njerëzit për Njerëzit" në rajonin Prespa

Në fillim të këtij sesioni Z. Damjan Surlevski bëri një prezantim duke u përqëndruar në mundësitë dhe idetë konkrete për aktivitetet e ardhshme të mundshme nën programin Njerëzit për Njerëzit. Ai informoi të pranishmit rreth organizimit të "Festivalit të Verës dhe Djathit" në Ohër të Maqedonisë, i mbështetur nga programi "Njerëzit për njerëzit". Gjithashtu, ai prezantoi tre idetë e mundshme të paraqitura në njësinë e menaxhimit të projektit nga antarët e palëve të interesuara për organizimin e aktiviteteve si: turi çiklistik Galicica, festivali i mollës dhe seminari për paketat e integruara turistike në rajonin ndërkufitar të Prespës. Kështu, në lidhje me organizimin e seminarit për paketat turistike të integruara, si një aktivitet të sugjeruar nga palët e interesuara gjatë mbledhjes së mëparshme, u diskutua mundësia e realizimit të aktivitetit gjatë muajit Dhjetor 2015.

Në vazhdim, Z. Damjan Surlevski ftoi pjesëmarrësit në një diskutim të hapur në lidhje me mbështetjen e mundshme në të ardhmen të eventeve nën programin "Njerëzit për Njerëzit". Duke parë numrin e vogël të dërguar për shprehjen e interesit për aktivitete për rajonin e Prespës, krahasuar me rajonet e tjera ndërkufitare, u sugjerua që të ridërgohet formulari i aplikimit dhe të inkurajohen aktorët për të aplikuar. Gjithashtu gjate diskutimit, u sugjeruar krijimi i kontakteve të reja me sektorin privat dhe strukturat e reja të krijuara nga reforma administrative territoriale në Shqipëri. Këto takime do të shërbejnë edhe për të inkurajuar ata të aplikojnë dhe të organizojnë aktivitete nën programin "Njerëzit për Njerëzit".

Gjithashtu, njësia e menaxhimit të projektit Prespa, do të vazhdojë të bashkëpunojë me grupin e palëve të interesuara për krijimin dhe plotësimin e një bazë të dhënash në lidhje me projektet e zbatuara në rajon.

Sesioni 5

Diskutim rreth projekt propozimeve për Zhvillimin e Integruar Ekonomik. Vendosija e partneriteteve në vazhdimësi rreth thirrjeve për aplikime në rajonin ndërkufitar "Prespa"

Gjatë këtij sesioni Z. Damjan Surlevski theksoi rëndësinë e zhvillimit të integruar ekonomik përmes lehtësimit të rretëzimit dhe bashkëpunimit midis popullsisë lokale, sipërmarrësve, sektorin e vogël bujqësor, ofruesit e shërbimeve lokale të turizmit dhe



aktorëve të tjerë të komunitetit rural në rajonet ndërkufitare për organizimin e proceseve të përbashkëta të punës, ndarjen e burimeve dhe vendosjen e ofertave të përbashkëta të tregut. Pra, fokusi ishte në rritjen e investimeve për futjen e proceseve të reja të prodhimit që do të përmirësojnë produktet dhe/ose shërbimet, si dhe promovimin e rajonit dhe burimet e tij përmes produkteve unike rajonale turistike të integruara. Përveç kësaj, tre prioritetet e projektit të identifikuar nga grupi i aktorëve Prespa: “Prespa në pëllëmbën tuaj”, “Fara të reja për bio-trashëgiminë” dhe “Gratë dhe kohezioni socio-ekonomik”, u diskutuan si projekte potenciale të mundshme për aplikime në thirrje të ndryshme për propozime në të ardhmen.

Ai gjithashtu prezantoi skemat e zbatuara të granteve gjatë fazës së mëparshme të projektit në rajonet ndërkufitare Drina-Tara dhe Drina–Sava, si një përvojë e mirë me ndikim pozitiv për rajonet.

Në diskutim u konkludua se Njësia e Menaxhimit të projektit (PMU) dhe SWG do të vazhdojnë të shërbejnë si një pikë informacioni ku anëtarët e grupit (SHG) do të marrin informacionin e nevojshëm për thirrjet e reja për propozime dhe programe. Ata do të vazhdojnë të mbështesin në përgatitjen e kërkesave për thirrje të ndryshme për propozime si edhe do të mbështesin në përgatitjen e aplikimeve dhe partnerëve për programe aktive IPA, CBC në realizimin e projekteve të përbashkëta në rajon. SWG dhe Njësia e Menaxhimit të projektit Prespa, janë vazhdimisht duke kërkuar për potenciale për mobilizimin e burimeve dhe janë të fokusuar në gjetjen e mundësive të tjera për mbledhjen e fondeve në kuadër të fondeve të BE dhe donatorë të tjerë aktivë në nivel kombëtar dhe rajonal, me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të integruar ekonomik të rajonit. Në vazhdim të diskutimit Z.Damjan Surlevski prezantoi nismën e re të projektit (LEIWW) ndërmjet SWG dhe GIZ, i cili është në fazën fillestare dhe mund të jetë një nga mundësitë për palët e interesuara. Sesioni vazhdoi me prezantimin nga Z. Benjamin Mohr, Udhëheqës i Ekipit në GIZ, i cili bëri një prezantim të detajuar të projektit "Zhvillimin rural përmes menaxhimit të integruar të pyjeve dhe ujërave në EJK" (LEIWW). Fokusi i prezantimit dhe diskutimit ishte se si programi LEIWW dhe nën masat e qasjes ABDA mund të ndërlidhen me aktivitetet e vazhdueshme ABDA në rajon. Gjithashtu si pjesë e këtij projekti të mundshëm ekziston mundësia për zbatimin e skemës së granteve të destinuara për rajonet ndërkufitare nën ABDA, duke u përqëndruar në zhvillimin e integruar ekonomik duke respektuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore (pyjeve dhe ujërave).

Sesioni 6

Zhvillimi rural nëpërmjet ujit dhe menaxhimi i pyjeve në Evropën Juglindore



Gjatë këtij sesioni, u prezantua shkurtimisht, edhe një herë objektivi i përgjithshëm i programit ABD-në rajonin ndërkufitar "Prespa" duke u fokusuar në masat tashmë të përgatitura, I dhe II;

MASA 1: Zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomisë rurale

Nën Masa 1.1: Zhvillimi i ekonomisë rurale përmes iniciativave të përbashkëta rajonale për zhvillimin e ofertës së integruar të produkteve dhe shërbimeve

Nën Masa 1.2: Rritja e punësimit dhe konkurrueshmëria e rajonit nëpërmjet forcimit të zinxhirëve të vlerave dhe ngritjen e kapaciteteve

Nën Masa 1.3: Mbështetja e investimeve individuale në zhvillimin e bizneseve në kuadër të nismave rajonale
--

Masa 2: Përmirësimet e mjedisit të ekonomisë rurale
--

Nën Masa 2.1: Mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore

Masat e Programit "Prespa" 2014-2020

Në vazhdim të sesionit Z. Damjan Surlevski paraqiti konkluzionet e grupit të punës për zhvillimin e integruar ekonomik gjatë Forumit të Politikave Bujqësore (APF 2015). Në grupin e punës ekspertë të ndryshme ndërkombëtare, përfaqësues të SWG-së, GIZ dhe anëtarët e ekipit ABDA diskutuan për mundësinë e lidhjes së programit ABDA dhe LEIWW duke konkluduar se:

- Veprimet e ardhshme që synojnë zonat ndërkufitare rurale duhet të ndërtohen mbi masat e përcaktuara tashmë në kuadër të dokumenteve të programimit ABDA;
- Skema të mundshme të granteve në të ardhmen duhet të fokusohen në qëndrueshmërinë ekonomike me fokus të veçantë shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- Koordinimi i autoriteteve lokale dhe kombëtare në procesin e programimit të zhvillimit rural është i një rëndësie thelbësore; dhe
- Angazhimi i mbështetur me kontributin financiar nga qeveritë e Ballkanit Perëndimor do të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të zonave ndërkufitare rurale.

Grupi i punës gjatë Forumit të Politikave Bujqësore, APF 2015, punoi dhe paraqiti prioritetet për zhvillimin e rajoneve ndërkufitare si edhe propozoi lloje të ndryshme të veprimeve që do të jenë të pranueshme në kuadër të Programit ABDA për zhvillimin ekonomik të rajonit ndërkufitar "Prespa" (2014 -2020). Llojet e propozuara të veprimeve janë si më poshtë:



- ✓ *Procesi i prodhim/përpunimit të gjelbërt dhe rritjen e cilësisë së produkteve tradicionale/tipike, si edhe risitë, marketingu dhe standartizimi për rritjen e konkurrencës:*
 - Qëndrueshmëria e mbledhjes dhe përpunimit të produkteve të erga;
 - Prodhimi bujqësor organik dhe përpunimi ekologjik i produkteve bujqësore;
 - Shfrytëzimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe masat e kursimit të energjisë;
 - Krijimi i kooperativave dhe grupimeve të gjelbra, brenda kuadrit të shkurtër të zinxhirëve të vlerave bujqësore;
 - Prezantimi në standardet e cilësisë të bazuar në mbrojtjen dhe markat e produkteve tradicionale bujqësore dhe të egra pyjore.
- ✓ *Zhvillimi i turizmit - rural të bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;*
 - Zhvillimi i gjelbër i zinxhirëve të vlerave bujqësore/ushqimore/artizanale/ produkteve turistike/ofertat e rajonit;
 - Shfrytëzimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe masat e kursimit të energjisë;
 - Turizmi inovativ përmes shërbimeve dhe produkteve të reja të bazuara në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;
 - Prezantimi në standardet e cilësisë bazuar në markat e produkteve dhe shërbimeve turistike;
 - Krijimi i grupimeve të turizmit të gjelbër.

Sesioni vazhdoi me input-in e ekspertit të GIZ Z. Wehinger Thomas. Gjatë prezantimit Z. Wehinger vlerësoi si pozitive përvojën në lidhje me bashkëpunimin, partneritetin, zbatimin e skemave të granteve dhe aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve në rajonet Drina-Tara dhe Drina-Sava. Sesioni vazhdoi me diskutimin e hapur për krijimin e ideve më specifike të projekteve dhe veprimeve shtesë të mundshme që mund të mbështeten në kuadër të projektit të mundshëm LEIWW. Pjesëmarrësit propozuan idetë e mëposhtme për projekte dhe veprime të tjera në skemën e granteve të mundshme për rajonin:

- Zhvillimi i turizmit – krijimi i produkteve dhe paketave të përbashkëta;



- Shkëmbimi i përvojave në ujitje dhe menaxhimin e qëndrueshëm të sistemeve të ujitjes;
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe ndër-komunikimi brenda rajonit (linja e autobusit për të lidhur Prespën, Ohrin dhe Korçën);
- Marka dhe dyqanet lokale (dyqani Prespa për shitjen e produkteve lokale tradicionale);
- Promovimi, mbrojtja e peshkut dhe gatimeve të peshkut;
- Mbështetja e artizanëve - Përmirësimi i teknikave për përgatitjen e produkteve tradicionale (punimeve me grep, gastronomi etj);
- Promovimi i rajonit nëpërmjet ringjalljes së legjendave popullore dhe përrallave;

Sesioni 7

Konkluzione dhe mbyllja e takimit

Në sesioni e fundit u dhanë konkluzionet si mëposhtë:

- Njësia për menaxhimin e programit “Prespa” dhe SWG do të shërbejë si një pikë informative ku antarët e grupit (SHG) të marrin informacion për thirrje të reja për projekt propozime. Ata do të vazhdojnë të mbështesin në përgatitjen e aplikimeve për projekt propozime të ndryshme si edhe do të lehtësojnë partneritetet për programe aktive IPA, CBC në rajon;
- Njësia për menaxhimin e projektit “Prespa” do të bashkëpunojë me antarë të grupit të palëve të interesuara për krijimin e një database lidhur me projektet e realizuara në rajon;
- Gjithashtu do të lehtësohen takime dhe kontakte me biznesin, operatorë turistikë me qëllim gjetjen e objektivave të përbashkëta dhe krijimin e paketave të integruara turistike për Prespën;
- Zyra për menaxhimin e projektit “Prespa” do të vazhdojë të mbështesë idetë dhe do të ndihmojë në koordinimin e aktiviteteve potenciale (turi ciklistik Galicica, paketat e integruara turistike dhe festivali i molles) që mund të mbështeten nga programi “Njerëzit për Njerëzit”;



- Në vazhdimësi të takimeve zyra për menaxhimin e projektit “Prespa” do të kontaktojë me Bashkitë e reja të krijuara pas ndarjes së re administrative territoriale në Shqipëri, si dhe do të ftohen përfaqësuesit e tyre të marrin pjesë në takimet e grupit të palëve të interesuara (SHG) me qëllim njohjen më nga afër të punës së grupit në rajonin Prespa;
- Drafti i parë i Protokollit Operacional dhe Rregullorja e procedurës për grupin e aktorëve “Prespa” do të shqyrtohet sërish, dhe komentet duhet të dërgohen me e-mail deri më 16 nëntor, 2015. Dokumenti përfundimtar do të miratohet në takimin e ardhshëm;
- Faqja e internetit të rajonit Prespa do të promovohet në faqet e internetit të anëtarëve të grupit të aktorëve dhe gjithashtu link-et e faqeve të tyre të internetit do të vendosen në platformën zyrtare të Prespës për promovim. Faqja e internetit duhet të përmirësohet me dokumente të tjera relevante lokale dhe nacionale të rëndësishme për rajonin e Prespës. Përveç kësaj, duhet të bëhen përgatitje për krijimin e hartës interaktive elektronike të rajonit dhe vendosjen e saj në faqen e internetit të Prespës;
- Njësia për menaxhimin e projektit “Prespa” në bashkëpunim me palët e interesuara do të krijojnë dhe administrojnë faqen rajonale për rajonin ndërkufitar Prespa në rrjetin social Facebook;
- Projekti "Zhvillimi rural përmes ujit dhe menaxhimin e pyjeve në EJL" (LEIWW) është ende në fazën përgatitore dhe miratimi përfundimtar për vazhdimin dhe zbatimin e tij do të merret në asamblenë e ardhshme të SWG - së në Dhjetor 2015;
- Njësia për menaxhimin e projektit “Prespa” në bashkëpunim me anëtarët e grupit të aktorëve do të synojnë në mbledhjen, zhvillimin e veprime dhe ideve të tjera të cilat mund të mbështeten nga skema e granteve ose nga programi “Njerëzit për Njerëzit”.

Përgatiti:

Etleva Thimo

Koordinatorë Rajonale

Rajoni Ndërkufitar Prespa



South Eastern Europe



Regional Rural Development Standing Working Group



The project is funded by the European Union